

VENDIM
Nr. 152, datë 29.2.2016

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT TE BASHKIA KORÇË, TË DISA MJEDISEVE TË PRONËS ME EMËRTIMIN “SHTËPIA E USHTARAKËVE”, ME VENDNDODHJE NË BULEVARDIN “REPUBLIKA”

(Ndryshuar me VKM nr. 193, datë 15.3.2017)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, shkronja “b”, 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi,¹ nga Ministria e Arsimit dhe Sportit te Bashkia Korçë, për Agjencinë e Zhvillimit Rajonal Korçë dhe institucione të tjera, të disa mjediseve të pronës me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në bulevardin “Republika”, sipas formularit për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 530, datë 7.8.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për Universitetin “Fan S. Noli”, në Korçë, të pronës nr. 549, me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në bulevardin “Republika”, Korçë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Arsimit dhe Sportit, Kryetari i Bashkisë Korçë dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama


¹ VKM nr. 193, datë 15.3.2017 botuar në F.Z nr. 54, datë 20.3.2017 në pikën 1 dhe 2 të tij shprehet: “1. Revokimin e së drejtës së pronësisë për Bashkinë Korçë, të mjediseve të katit të parë teknik, të pronës me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me sipërfaqe ndërtimi 348 (treqind e dyzet e tetë) m², dhe heqjen e këtyre mjediseve nga formulari që i bashkëlidhet vendimit nr. 152, datë 29.2.2016, të Këshillit të Ministrave.

2. Mjediset e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, kalojnë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve të Brendshme.”


Formular Per Inventarizimin e Pronave Te Paluajtshme Shteterore
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Identifikoi: Specialist Institucioni : Bashkia Korçë Olgert Leno, Specialist i Pronave Publike Supervizoi: Specialist Zhaneta LUBONJA Drejtoreshë DPKZHT Fusha e perdorimit te Prones: Administrative Aprovoi: Sotirag FILO , Kryetari i Bashkise										
A		B					C			
Nr. Rend	Zona Kadastr. Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Dresa/Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne m ²	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/Entiteti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Entiteti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
967	8562	7/449	Shtepia e Ushtarakeve Bulevardi Republika Korce	Truall nen ndertese Objekt ndertimor Sperfaqja Funksionale	BLV "Republika" Korce Kati I pare Kati I dyle Kati I Trete	529 m ² 348 m ² 348 m ² 348 m ² 271 m ²	Administrate Administrate Administrate	Bashkia Korçë Bashkia Korçë Bashkia Korçë Bashkia Korçë Bashkia Korçë	Bashkia Korçë	Bashkisë Korçë do ti kalojë në pronësi sipërfaqja e tre kateve të objektivit ndërtimor . Siperfaqja e një kati është 348 m ² . Në total të treja katet kanë një sipërfaqe prej 1044 m ² . Bashkisë Korçë do ti kalojë truall funksional prej 271 m ² si dhe truallin nën objekt prej 529 m ² Ky objekt do të përdoret si sili e Agjensisë për Zhvillim Rajonal nr. 3. Në këtë sipërfaqe nuk do të përfshihen sipërfaqja e objektit prej 219 m ² që përdoret nda DRSHKP e cila ka kaluar në pronësi të saj me VKM nr. 76 datë 28.01.2015 si dhe sipërfaqja ndërtimore prej 310 m ² që përdoret si Qendër Rinore + podrum nga MMSR dhe ka kaluar në pronësi të saj me VKM nr. 201 datë 04.03.2015.

PLANIMETRI E KATIT TE PARE (EKZISTUESE) SH 1:75



PLANIMETRIE KATIT TE DYTE (EKZISTUESE) SH 1:75



PLANIMETRI E KATIT TE TRETE (EKZISTUESE) SH 1:75

